



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 121 Akti

Nr. 89 Vendimi
Tiranë, më 20.12.2018

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xensila Pine	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Marie Tuma, në Tiranë, më datë 18 dhjetor 2018, ora 10:00, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Znj. Eloida S. Goxhi, me detyrë prokurore, Drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Berat, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/ b, paragrafi 5 dhe nenet Ç, paragrafi 1, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Suela Zhegu, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. Eloida S. Goxhi, me detyrë prokurore, Drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Berat, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar më datë 15 janar 2018, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues nr. 3, të datës 15.03.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues, znj. Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar, znj. Marie Tuma.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: 1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (DSIK) dhe 3) Prokuroria e Përgjithshme (PP).

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillimin e hetimit administrativ.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi, “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi”.

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.01.2018, dërgohet raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

² Me shkresën nr. *** prot., datë 12.11.2017, dërgohet raporti i DSIK-së.

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga neni 14, pika 5, i ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

“Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet duken të sakta dhe në përputhje me ligjin.

Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Pasi u hetua raporti i Prokurorisë së Përgjithshme, nuk u gjet indice apo element që mund të ngrinte dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit”.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 06.12.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Më datë 07.12.2018, subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe u ngarkua të paraqesë shpjegime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me hetimin e kryer nga Komisioni, duke çmuar të njihet me dosjen, për të disponuar kopje të saj si dhe për të paraqitur shpjegime/prova. Gjithashtu, znj. Eloida Goxhi, deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Eloida Goxhi ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit.

³Me shkresën nr. *** prot., datë 03.05.2018, dërgohet raporti i Prokurorisë së Përgjithshme.

PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Subjekti i rivlerësimit, znj. Eloida Sebahudin Goxhi, me detyrë prokurore, Drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Berat, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt përfshiu: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Gjatë procedurës së rivlerësimit të subjektit janë administruar akte nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Agjencia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a., Shoqëria “Ujësjetës-Kanalizime” sh.a., Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor.

I. VLERËSIMI I PASURISË

Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë

Në bazë të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbljes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, relatori i çështjes ka kryer hetimin dhe vlerësimin e pavarur të të gjitha fakteve dhe rrethanave lidhur me vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke kërkuar informacion nga subjektet e së drejtës publike, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ i thelluar i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, fshehje të pasurisë, deklarim të rremë apo konfliktin e interesit, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur.

Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga znj. Eloida Goxhi, në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

Në deklaratën e pasurisë sipas formularit (shtojca 2) të datës 25.01.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, këto pasuri:

1. Pasuri (bono thesari me vlerë 2.2 milion lekë)

Në mënyrë të përmblodhur, referuar të dhënave të deklaratës së pasurisë, subjekti ka asetë dhe detyrime deri më datë 24.01.2017, si më poshtë;

1. Obligacione në “Intesa Sanpaolo Bank”, në vlerën 1.200.000 lekë. Zotërimi: 100 %.

- | |
|-------------------------------------------------------------------------------------|
| 2. Obligacione në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 1.000.000 lekë. Zotërimi: 100 %. |
| 3. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 110.802 lekë. Zotërimi: 100 %. |

Vlera e pasurisë bruto/neto është 2.310.802 lekë.

Hetimi i kryer nga Komisioni është përqëndruar në:

- *Vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit.*
- *Burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.*

Lidhur me këto pasuri subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se:

1.1 Shuma prej 1.200.000 lekësh, e depozituar nga viti 2011 - 2014, pranë “Intesa Sanpaolo Bank”, si investim në obligacion qeveritar 5 vjeçar, me normë fikse 4.95 %, me datë valute 8 shkurt 2016. Të ardhura nga investimi 29.700 lekë, kredituar në datë 8 gusht 2016. Zotërimi: 100 %.

Burimi krijimit: kursimet nga paga si prokurore.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës këto dokumente:

Vërtetim nga “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 04.01.2017, ku vërteton se, znj. Eloida Goxhi, ka blerë obligacione në vlerën nominale 1.200.000 lekë, me afat 5 vjeçar dhe kreditim interesash çdo muaj, nga të cilat ka përfituar shumën prej 29.700 lekësh. Taksa e mbajtur në burim, më datë 08.08.2016, në vlerën 4.455 lekë. Përfitimi neto nga obligacioni në fjalë është në vlerën 25.245 lekë.

“Intesa Sanpaolo Bank” me shkresën nr. ***, më datë 21.7.2017, konfirmon se, znj. Eloida Goxhi, disponon më datë 24.01.2017, bono thesari në vlerën 1.200.000 lekë dhe llogari rrjedhëse në vlerën 23.907 lekë. (Aneksi nr. 9)

Komisioni ka kryer hetim ⁴duke ju drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë dhe institucioneve financiare/leasing të cilat zhvillojnë aktivitet brenda vendit.

“Intesa Sanpaolo Bank” ka konfirmuar se, znj. Eloida Goxhi, disponon më datë 24.01.2017, bono thesari me vlerë 1.200.000 lekë dhe llogari rrjedhëse, më datë 27.03.2018, me vlerë 97.542 lekë.

- ✓ *Komisioni nga hetimi i kryer ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me të dhënat e ardhura nga banka: “Intesa Sanpaolo Bank”.*

⁴ Shih për më tepër në dosje shkresën me nr. *** prot., datë 21.03.2018, drejtuar Bankave që operojnë në Shqipëri. Shih në dosje përgjigjen me nr. *** prot., datë 10.04.2018. ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

1.2 Shuma prej 1.000.000 lekësh, depozituar pranë “Raiffeisen Bank”, si investim në obligacion qeveritar 5 vjeçar, me normë fikse 5.25 %, me datë valute 8 nëntor 2016. Zotërim: 100%.

Burimi i krijimit: Kursimet nga paga si prokurore nga viti 2015 - 2016.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës këto dokumente:

Vërtetim nga “Raiffeisen Bank”, më datë 06.01.2017, ku vërteton se, znj. Eloida Goxhi, ka obligacione me gjendje, më datën 24.01.2017, në vlerën 1.000.000 lekë, datë valute 08.11.2016.

“Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. ***, datë 19.07.2017, konfirmon se, znj Eloida Goxhi, disponon bono thesari, me gjendje në datë 24.1.2017, në vlerën 1.000.000 lekë.

⁵Komisioni ka kryer hetim për këtë pasuri, duke kërkuar informacion nga “Raiffeisen Bank”. “Raiffeisen Bank”, ka konfirmuar se znj. Eloida Goxhi, ka investuar në letra me vlerë, “obligacione” në bono thesari, në vlerën 1.000.000 lekë, me datë 08.11.2016 dhe me datë maturimi 08.11.2021.

✓ *Komisioni nga hetimi i kryer ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me të dhënat e ardhura nga ‘Raiffeisen Bank’.*

1.3 Llogari rrjedhëse në lekë, pranë “Raiffeisen Bank”, me gjendje në vlerën 110.802 lekë. Zotërimi: 100 %. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga si prokurore.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës këto dokumente:

Vërtetim nga “Raiffeisen Bank”, më datë 06.01.2017, ku vërteton se, znj. Eloida Goxhi, ka llogari rrjedhëse me gjendje, më datë 24.01.2017, me vlerë 110.802 lekë. Kjo llogari është hapur që në datë 31.10.2008.

“Raiffeisen Bank”, me përgjigjen e ardhur, ka konfirmuar se, znj. Eloida Goxhi, disponon Llogari “page” në lekë, me gjendje 653.005 lekë.

✓ *Komisioni nga hetimi i kryer ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.*

1.4 Subjekti ka deklaruar se banon ne banesën e prindërve, apartament, me sipërfaqe 76.9 m², në bashkëpronësi të prindërve: S. dhe V. G, me adresë: Rr. “***”, ndodhur në Tiranë, fituar nga privatizimi i banesave shtetërore në vitin 1993.

Burimi i krijimit: sipas kontratës së shitblerjes, me datë 14.08.1993, me palë: Enti Kombëtar i Banesave, pala shitëse, dhe S. G dhe V. G, pala blerëse, i blerë në shumën 23.297 lekë.

⁵ Shih për më tepër në dosje shkresën me nr. *** prot., datë 21.03.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë. Shiko në dosje përgjigjen me nr. *** prot., datë 30.03.2018, ardhur nga “Raiffesin Bank”.

ZVRPP-ja Tiranë, me përgjigjen e ardhur⁶ ka konfirmuar banesën e prindërve, të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, ZK ***, apartament, me sipërfaqe 76.9 m², në bashkëpronësi të S. G (babai i subjektit) dhe V. R. G (nëna e subjektit), me adresë, Rr. “***”, Tiranë, bashkëlidhur dokumentacioni.

Komisioni, konstaton se subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2010 ka deklaruar adresë banimi, Lagja: Nr. ***, Rr. “***”, Tiranë, ndërsa në pyetësor dhe në deklaratën “Vetting”, në deklaratën periodike nga viti 2010 deri në vitin 2017 si adresë vendbanimi ka deklaruar, Njësinë Bashkiake Nr. ***, Rr. “***”, Tiranë, adresë e cila përputhet me adresën e banesës së prindërve të saj, sipas dokumentacionit bashkëlidhur nga përgjigja e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë.

✓ *Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.*

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

Subjekti ka deklaruar këto të ardhura:

- ✓ Të ardhura nga bursa në Shkollën e Magjistraturës, nga viti 2008 deri në vitin 2010. Shuma 1.020.000 lekë.
- ✓ Të ardhura nga paga neto, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për periudhën tetor viti 2010 - nëntor viti 2011. Shuma 882.887 lekë.
- ✓ Të ardhura nga paga neto, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, për periudhën nëntor 2011 - 31 dhjetor 2016. Shuma 5.044.575 lekë.

Subjekti ka deklaruar të ardhura në vlerën 6.947.462 lekë, të cilat përputhen me dokumentacionin e dorëzuar.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. 511, datë 18.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës, për periudhën 2008 - 2010.
- Vërtetim datë 14.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, për periudhën tetor 2010 - nëntor 2011.
- Vërtetim nr. 27, datë 05.01.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, për periudhën nëntor 2011 – dhjetor 2016.

✓ *Komisioni konstaton se deklarimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e administruar në dosje.*

Komisioni ka kërkuar informacion nga çdo subjekt i të drejtës publike sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016” nga i cili ka rezultuar se,

✓ *Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e ardhur nga institucionet.*

⁶ Shiko për më tepër në dosje të Komisioni përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja, Tiranë, me nr. *** prot., datë 18.04.2018 e cila konfirmon se në emër të subjektit nuk figurojnë pasuri të regjistruara.

Nga të dhënat e sistemit *TIMS*, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka lëvizur shumë pak herë jashtë kufirit shqiptar, te cilat janë reflektuar në analizën financiare.

ANALIZA FINANCIARE

Analiza financiare për këtë subjekt përfshin periudhën nga data 15.10.2010 e deri në Dhjetor 2016, rezulton që të ardhurat e gjeneruara nga paga superojnë shpenzimet dhe pasuritë. Kjo e fundit konsiston vetëm në likuiditete. Shih tabela 1, Kolona Total 2010 - 2016.

Tab. 1 Analiza mbi aftësitë për të krijuar pasuri 2010 - 2016

Nr	Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL 2010- 2016
1	TË ARDHURA	169.773	817.642	872.592	861.982	1.059.919	981.967	1.163.587	5.927.462
	Paga nga puna si prokurore	169.773	817.642	872.592	861.982	1.059.919	981.967	1.163.587	5.927.462
2	SHPENZIME	40.268	246.717	330.789	469.115	524.768	362.907	393.417	2.367.980
	Shpenzime jetese sipas ILDKPI-së	40.268	193.289	193.289	193.289	193.289	193.289	193.289	1.200.000
	Shpenzime udhëtimi sipas <i>TIMS</i> dhe pyetësorit	-	28.428	-	138.326	193.979	32.118	62.628	455.480
	Shpenzime transporti	-	25.000	137.500	137.500	137.500	137.500	137.500	712.500
3	Diferenca Likuiditeti (Shitesa/Pakësi me)	92	298.906	370.618	266.315	305.537	436.636	630.653	2.308.758
	<i>Likuiditete Gjendje (a+b)</i>	92	298.998	669.616	935.931	1.241.468	1.678.105	2.308.758	
a.	Likuiditet nëpër banka	92	8.998	339.616	405.931	811.468	1.678.105	2.308.758	
b.	Likuiditet <i>cash</i>		290.000	330.000	530.000	430.000	-	-	
	DIFERENCA PËR SHPENZIME TË TJERA (1-2-3)	129.412	272.019	171.185	126.553	229.614	182.424	139.517	1.250.724

Në analizën financiare e cila fillon nga data 15.10.2010 datë kur subjekti fillon detyrën e prokurorit - e deri në Dhjetor 2016, rezulton që të ardhurat e gjeneruara nga paga superojnë shpenzimet dhe pasuritë. Kjo e fundit konsiston vetëm në likuiditete. Shih Tabela 1, Kolona Total 2010 - 2016.

1. Në dhjetor 2012, është hapur një depozitë në shumën prej 300.000 lekë në “Raiffeisen Bank”, e cila është formuar nga tepricat pozitive të pa tërhequra nga paga e përfituar gjatë vitit 2012.
2. Në dhjetor 2015 është hapur një llogari e re në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën prej 1, 2 Mil Lekë, shumë e formuar si vijon:
 - Shuma prej 800.000 lekësh është tërhequr nga “Raiffeisen Bank”.
 - Shuma prej 400.000⁷ lekësh nga gjendja *cash* e formuar ndër vite.

Tab. 2 Gjendja e likuiditeteve gjatë vitit 2015

Pasuria	Gjendja në fillim të 2015	Investuar gjatë 2015	Gjendja në fund të 2015
Në banka	811.468	1.200.000	1.678.105
<i>Cash</i>	430.000		-
Total	1.241.468 ⁸	1.200.000	1.678.105 ⁹

Aftësia e subjektit të rivlerësimit për krijimin e likuiditeteve në shumën prej 1.241.468 lekësh, deri në fund të vitit 2014, është shprehur në tabelën nr. 3.

Tab. 3 Analiza mbi mundësinë e kursimeve deri para vitit 2015

Nr.	Përshkrimi	2010 - 2014
1	TË ARDHURA	3.781.908
	Paga nga puna si prokurore	3.781.908
	Interesa Bankare	-
2	SHPENZIME	1.611.656
	Shpenzime jetese sipas ILDKPI-së	813.423
	Shpenzime udhëtimi sipas TIMS dhe pyetësorit	360.734
	Shpenzime transporti	437.500
3	PASURI	1.241.468
	Likuiditet (Shtesa/Pakësime)	1.241.468
	DIFERENCA TË MUNDSHME PËR KURSIM (1-2-3)	928.783

Siç shihet nga tabelat më sipër, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të krijojë investimet në “Bono Thesari” prej “kursimeve nga paga” sikurse ka deklaruar në DPV-të 2011-2014, në deklaratën “Vetting” dhe në pyetësorin dërguar për specifikimin e *cash-it*.

⁷ Subjekti, ka deklaruar në deklaratën “Vetting” shumën prej 1,2 milion lekësh të krijuar me kursimet nga paga e viteve 2011- 2014. Gjithashtu, në DPV-të e viteve 2011-2015, ka deklaruar “kursime nga paga”.

Në të dyja deklaratimet, nuk ishte specifikuar nëse këto kursime ndodhen në bankë apo *cash*. Nga pyetësori dërguar subjektit për këtë saktësim, rezulton se në fund të vitit 2014, gjendja e *cash-it* është 430.000 lekë.

⁸ Shtesa të likuiditeteve të mbartura nga vitet e mëparshme, dhjetor 2010- dhjetor 2014.

⁹ Kjo shumë përbëhet nga depozita prej 1,2 milion lekësh dhe 478.105 lekë e cila është balanca e llogarisë së pagës – të dyja në dhjetor 2015

Gjithashtu, në vitin 2016 subjekti ka investuar në “Bono Thesari” vlerën prej 1 milion lekë, në “Raiffeisen Bank”. Situata e likuiditeteve në këtë bankë prezantohet në tabelën nr. 4.

Tab. 4 Gjendja e likuiditeteve gjatë vitit 2016 – “Raiffeisen Bank”

Likuiditeti	Gjendja në fillim vitit 2016	Investuar gjatë vitit 2016	Gjendja në fund 2016
Në “Raiffeisen Bank”	478.105	1.000.000	84.851

Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë së pagës në “Raiffeisen Bank”, duket qartë që vlera prej 1 milion lekë është formuar tërësisht nga kursimet/mostërheqjet e pagës së subjektit:

- Teprica pozitive e trashëguar nga 31 dhjetori 2015;
- Teprica nga paga, të cilat nuk janë tërhequr gjatë vitit.

Tab. 5 Analiza mbi mundësinë e kursimeve brenda vitit 2016

Nr.	Përshkrimi	2016
1	TË ARDHURA	1.163.587
	Paga nga puna si prokurore	1.163.587
2	SHPENZIME	393.417
	Shpenzime jetese sipas ILDKPI-së	193.289
	Shpenzime udhëtimi sipas TIMS dhe pyetësorit	62.628
	Shpenzime transporti	137.500
3	PASURI	630.653
	Likuiditet nëpër banka (Shtesa/Pakësime)	630.653
	DIFERENCA PËR SHPENZIME TË TJERA (1-2-3)	139.517

Konkluzioni bazuar në analizën financiare:

- ✓ *Komisioni, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e likuiditeteve, në vlerën prej 2.308.758 lekë.*

Konkluzioni për vlerësimin në tërësi të pasurisë.

Nga vlerësimi i provave të marra gjatë këtij hetimi administrativ, ka rezultuar se nuk ka dyshime mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe llogaritë e subjektit të rivlerësimit, përfshi dhe llogaritë e personave të lidhur me të. Po kështu, në të gjitha rastet e hetuara përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjet e ardhura nga institucionet shtetërore.

Për sa më sipër, nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se nuk janë konstatuar elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklarim të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet në deklaraten “Vetting” përputhen me deklarimet

periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit. Pas verifikimit, ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin.

II. KONTROLLI I FIGURËS

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës.

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi.

Për vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke bërë disa verifikime mbi pastërtinë e figurës, duke hetuar mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Rekomandimi për vlerësimin e kontrollit të figurës.

Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

✓ *Për sa i përket elementit të pastërtisë së figurës, për subjektin e rivlerësimit konstatohet se, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës si prokurore.*

III. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi vlerësimin e aftësive profesionale

Prokuroria e Përgjithshme me shkresën me nr. ***prot., datë 03.05.2018, ka përcjellë pranë Komisionit, Raportin e përgatitur nga Grupi i Punës për subjektin e rivlerësimit, znj. Eloida Sebahudin Goxhi, me funksion Drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Berat, si organi ndihmës për vlerësimin profesional të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1- Formularit të vetdeklarimit.
- 2- Tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit si dhe 5 dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.
- 3- Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Eloida Goxhi, për periudhën nëntor 2011 deri më janar 2016, ka ushtruar funksionin e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat. Për periudhën nga 14 Janar 2016 e aktualisht ushtron detyrën e Drejtueses së Prokurorisë në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat. Prokurorja Eloida Goxhi, rezulton të ketë trajtuar gjithsej 707 (*shtatëqind e shtatë*) çështje, të cilat iu nënshtruan shortit.

1. Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka konstatuar saktësinë e Formularit të Vetëdeklarimit, i plotësuar sipas udhëzimit të shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Nga analizimi i 3 dokumenteve të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe 5 dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) *Aftësitë profesionale;*
- b) *Aftësitë organizative;*
- c) *Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe*
- d) *Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.*

a) Aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit, prokurorja Eloida Goxhi, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore të paraqitura prej saj si dhe në 5 dosjet/praktikat e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme, jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste, analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore dhe nënligjore apo me praktikën gjyqësore. Ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur prej saj, në respektim të dispozitave procedurale penale dhe akteve nënligjore. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, ka aftësi në arsyetim ligjor. Lidhur me nivelin e arsyetimit të akteve të vëzhguara, subjekti i rivlerësimit respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Konstatohet se në ushtrimin e funksionit të Drejtueses së Prokurorisë, prokurore Eloida Goxhi, subjekt rivlerësimi, në rastet kur disponon me vendime shfuqizimi, arsyeton vendimin e saj mbështetur në dispozita ligjore, analizon në tërësi rrethanat e faktit, të dhënat e grumbulluara gjatë hetimit dhe mangësitë e hetimit. Bën vlerësim të sajën mbi faktet dhe provat, ndjek një linjë të caktuar arsyetimi me lidhje logjike dhe shpreh qëndrimin e saj me akt të motivuar. Është e qartë në disponimin e saj përfundimtar. Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se: është vlerësuar “*Shumë Mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej saj.

b) Aftësitë organizative

Subjekti rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, për periudhën e rivlerësimit nga 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat përgjatë periudhës 08.10.2013 deri më 14.01.2016 dhe nga kjo datë e në vazhdim ka ushtruar detyrën e Drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.

Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar kompetencat që ligji i njej prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me efekt të menjëhershëm. Veprimtaria e saj në ushtrim të funksionit kushtetues, rezulton në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

Ka kryer detyrat e saj në përputhje me pikën 2 dhe 2.1 të urdhërit nr.147, datë 09.05.2008, *“Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në Prokuroritë e Shkallës së Parë”*, të Prokurorit të Përgjithshëm që përcakton se vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve, kërkesa për gjykimin e çështjes, konkluzionet përfundimtare dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes dhe detyrimin e prokurorit të çështjes për të diskutuar paraprakisht me drejtuesin e prokurorisë, kërkesat për caktimin e masave të sigurimit, vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve dhe konkluzionet përfundimtare për deklarimin e fajësisë dhe caktimin e llojit e masës së dënimit, nga ku rezulton dakordësia në të gjithë dokumentet e vëzhguara.

Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin, mbështetur në nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale dhe akteve nënligjore, që e përcaktojnë atë si prokuror më i lartë me fuqinë e ndryshimit dhe shfuqizimit të vendimeve të marra nga prokurori më i ulët si dhe mbështetur në ligjin nr. 8737, datë 12.02.2001, *“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, etj. Ajo ka përballuar ngarkesën e punës, me efikasitet. Konstatohet se aktet janë marrë brenda afateve ligjore.

Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurorja Eloida Goxhi, është efiçente dhe efektive. Në efiçitetin dhe efiçencën e veprimtarisë së saj nuk ka ndikuar ngarkesa sasiore, e cila ka qenë e lartë.

c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet/praktikat e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Konstatohet se, nga dokumentet ligjore të vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit për subjektin e rivlerësimit, prokurores Eloida Goxhi. Në dokumentet ligjore dhe në aktet e dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nuk

janë evidentuar raste që subjekti i rivlerësimit, prokurorja Eloida Goxhi, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Konstatohet se, në dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Subjekti i rivlerësimit prokurorja, znj. Eloida Goxhi, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, me titull *magjistrat*, profili prokuror.

Prokurorja Eloida Goxhi, subjekt rivlerësimi, ka fituar titullin “*Avokat*” me nr. licence 2404, më datë 04.12.2004. Për sa i përket trajnimeve të kryera, subjekti i rivlerësimit, rezulton të jetë angazhuar me pjesëmarrjen e saj, në trajnimet e kryera nga Shkolla e Magjistraturës.

3. Të dhëna nga burime arkivore

Nga verifikimi i të dhënave nga Sektori i Protokoll – Arkivit si dhe burimeve Arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, në Prokurorinë e Përgjithshme nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi:

- *Të ketë pasur masa disiplinore apo të jenë depozituar ndaj tij ankesa lidhur me punën e kryer.*
- *Të ketë të dhëna apo indice të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.*
- *Të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).*
- *Të ketë pasur ndaj tij procedime penale të mosfilluara, pushuara apo pezulluara nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, Prokuroria për Krime të Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme.*

IV. DENONCIMET NGA PUBLIKU

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua dhe në 3 denoncime, të paraqitura pranë Komisionit, përkatësisht:

*1. Denoncimi me nr. *** prot., datë 24.11.2017, nga denoncues Xh. M. H.*

Subjekti i rivlerësimit denoncohet si Drejtuese e Prokurorisë për moskryerje të veprimeve hetimore.

Komisioni me shkresën me nr. ***¹⁰ prot., datë 30.10.2018, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, duke kërkuar të verifikohen ankesat e sipërcituara dhe të na njoftohen rezultatet e verifikimit.

Prokuroria e Përgjithshme me shkresën me nr. *** prot., datë 30.10.2018, ka konfirmuar se: *“Referuar akteve të administruara për procedimin penal nr. ***, të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit, zj. Eloida S. Goxhi, ka ushtruar vetëm funksionet si Drejtuese e Prokurorisë në lidhje me këtë procedim penal, komfor parashikimeve të ligjit 97/2016 " Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.*

- ✓ *Komisioni vëren se, zvarritja e konstatuar nga verifikimi lidhet drejtpërdrejt me veprimet e prokurorit të çështjes, O. R, pasi kallëzimi penal me nr. ***, datë 29.09.2016, i është siglur "për vlerësim" prokurorit O. R;*
- ✓ *Nga drejtuesja e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat janë respektuar të drejtat e palëve në procesin penal.*

2. Denoncimi me nr. *** prot., datë 25.09.2018, me denoncuese: A. Q (J.) dhe M. B (J.).

Subjekti i rivlerësimit denoncohet si Drejtuese e Prokurorisë, për shkelje të ligjit. Denoncueset i kërkojnë Drejtueses së Prokurorisë Berat një “vërtetim” që është hapur çështja hetimore për kallëzimin penal, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, për ta përdorur në një proces gjyqësor në Gjykatën e Apelit Vlorë.

- ✓ *Komisioni nga verifikimi i kryer vëren se, denoncueset ngrejnë pretendimet e tyre ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, si Drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Berat, duke kërkuar vënien në dispozicion të një “vërtetimi” për ta përdorur si provë në gjykimin e një çështje, në Gjykatën e Apelit Vlorë.*

Trupi gjykues bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, në verifikimin e kryer nga Prokuroria e Përgjithshme si dhe nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit ka konkluduar se, lidhur me këto 2 denoncime, pretendimet e ankuesve nuk mund të provohen.

3. Denoncimi i ardhur pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 19.01.2018, që i përket denoncueses B. H. M.

Objekti i denoncimit: Denoncohet, prokurore Eloida Goxhi, për zvarritje të hetimit.

1. Denoncuesja ndër të tjera parashtron se : *“Jam një pensioniste që kam 11 vjet nëpër gjyqe për pronën, subjekti i rivlerësimit, prokurore Eloida Goxhi, ka mbajtur rreth 2 vjet dosjen në sirtar dhe vetëm kur i jam drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme atëherë e ka dërguar dosjen për gjykim, duke gënjer dhe pa hetuar”.*

¹⁰ Shiko në dosje shkresën me nr. *** prot., datë 30.10.2018, drejtuar Prokurorisë Përgjithshme dhe përgjigjen e ardhur me shkresën me nr. *** prot., datë 30.10.2018.

2. Denoncuesja ka paraqitur një kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, për të cilin është regjistruar procedimi penal nr. *** në vitin 2010, për të cilin më parë, më datë 07.07.2010, kjo prokurori kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal.

3. Ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, denoncuesja B. H. M, ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, e cila, më datë 29.09.2010, vendosi rrëzimin e ankimit.

4. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, denoncuesja B. M, ka paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Apelit Vlorë. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 09.10.2012, vendosi :

- Ndryshimin e vendimit, datë 29.09.2010, të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Berat.
- Pranimin e ankimit të znj. B. M.
- Prishjen e vendimit, datë 07.07.2010, të Prokurorisë së Rrethit Berat dhe urdhërimin e organit procedues të vazhdojë hetimet.

5. Në zbatim të vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Vlorë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, ka regjistruar procedimin penal të datës 20.05.2013, për veprën penale të, “*Mashtrimi*”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

6. Subjekti i rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, është caktuar si prokurore zëvendësuese për të hetuar mbi këtë çështje nga drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Berat. Më datë 17.09.2013, prokurorja urdhëron oficerin e policisë gjyqësore, B. V, për kryerjen, e veprimeve procedurale. Më pas, për të njëjtat veprime procedurale, në dhjetor të vitit 2013, urdhëron që t’i kryejë brenda datës 10.01.2014, një tjetër oficer të policisë gjyqësore, A. A.

7. Rezulton se shtetasja B. M ka paraqitur ankimin nr. ***, më datë 16.09.2014, në Prokurorinë e Përgjithshme, për zvarritje në hetimet e procedimit penal.

8. Më datë 30.09.2014, prokurorja e çështjes, subjekti i rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, ka vendosur pushimin e çështjes.

9. Nisur nga analizimi i fashikullit të dosjes hetimore rezulton se:

Veprimet procedurale të urdhëruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, për t’u kryer brenda datës 10.01.2014, janë kryer jashtë afatit, në datat 25.05.2014, 12.05.2014, 10.04.2014, 05.05.2014, sipas verifikimit të akteve të dosjes së procedimit penal nr. *** të vitit 2013.

10. Kjo zgjatje e pajustificuar e hetimit është evidentuar edhe në shkresën me nr. ***^[2] prot., datë 30.10.2018, të Prokurorisë së Përgjithshme sipas së cilës: “*Nga aktet e administruara për këtë procedim penal rezulton zvarritje e pajustificuar e hetimit të çështjes.*”

11. Në seancë pyetur për këtë denoncim subjekti i rivlerësimit, znj. Eloida Goxhaj, u përgjigj se: “*Gjatë këtij viti janë kryer veprime hetimore lidhur me çështjen e caktuar, të cilat ishin lënë si detyrë nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë dhe pasi janë kryer veprimet është marrë vendimmarrja*”.

12. Trupi gjykues vëren se sa deklaroi subjekti i rivlerësimit në seancë dëgjimore, sipas verifikimit të akteve të dosjes së procedimit penal, nuk është ndërmarre asnjë veprim hetimor konkret nga subjekti i rivlerësimit, sipas orientimeve të evidentuara nga Gjykata e Apelit Vlorë, të tilla si: hetimi dhe procedimi mbi mënyrën e ushtrimit të detyrës dhe kompetencave nga personat e ngarkuar me drejtimin e kësaj shoqërie, prishja e likuidimin e saj, si dhe hetimit mbi mënyrën e administrimit konkret të kësaj shoqërie, vënien në likuidim dhe mospasqyrimin e të dhënave dhe ecurisë të gjithë kësaj veprimtarie në këto 16 vjet.

Në analizë për sa me sipër, trupi gjykues vlerëson se:

(i) Subjekti i rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, nuk ka ushtruar funksionin në përputhje me nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale, nën titullin, **“Funksionet e prokurorit”**, **“I. Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit.Drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.”**

(ii) Subjekti i rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, nuk ka ndërmarrë hapat hetimore në përputhje me nenin 304, pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, nën titullin, **“Veprimtarinë hetimore e prokurorit”**, në bazë të të cilit: *“Prokuroria duhet të kryejë të gjitha veprimet e mundshme hetimore për të provuar a) ekzistencën e faktit penal dhe b) autorin e veprës penale”*.

(iii) Subjekti i rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, nuk ka ndërmarrë veprime hetimore sipas orientimeve të evidentuara nga Gjykata e Apelit Vlorë në kundërshtim me pikën 42 të Vendimit Unifikues Nr. 2, datë 20.06.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas së cilit: *“Kur vendos shfuqizimin e vendimit, gjykata ka të drejtë të disponojë mbi kryerjen e veprimeve të tjera që kanë lidhje me akuzën dhe me veprimet hetimore të kryera deri në atë çast, në funksion të zbulimit të fakteve dhe të vërtetës për ushtrimin e ndjekjes penale sipas ligjit”*

Duke qenë se çështja nr. *** akti e vitit 2013, ishte e vetmja çështje ku u evidentuan këto shkelje, në zbatim të nenit 40, pika 1, germa “c”, nenit 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016, shumica e trupi gjykues, në referim të vendimit nr. 2 /2017 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: *“Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale..”*, vendosi: ta transferojë këtë çështje pranë organit kompetent për inspektim, për shkaqet e analizuara më lart, për t’u marrë në konsideratë për procedim disiplinor për subjektin e rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi.

Rekomandimi i relatorit për vlerësimin e aftësive profesionale.

Për sa më sipër, me cilësinë e relatores së çështjes, mbështetur në raportin e Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme. Nuk u gjet asnjë indice apo element që cenon figurën e prokurores, znj. Eloida Goxhi, sipas parashikimeve në nenin 44/a të ligjit nr. 84/2016, kështu që për subjektin e rivlerësimit propozoj: “e aftë”.

SEANCA DËGJIMORE

Duke qenë se subjekti i rivlerësimit u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, më datë 07.12.2018, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Marie Tuma, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, në seancë dëgjimore, më datën 18.12.2018, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, salla B, si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit.

Znj. Eloida Goxhi, është njoftuar nëpërmjet komunikimit elektronik, me *e-mail*, në datën 16.12.2018, me anë të të cilit edhe ka komunikuar marrjen dëgjimore dhe nuk ka pasur pretendime apo kërkesa të tjera shtesë.

Në seancën dëgjimore të datës 18.12.2018, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe deklaroi se ishte dakord me gjithë hapat procedural të ndjekur nga trupi gjykues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, dha shpjegimet e saj lidhur me 3 denoncimet e paraqitura pranë Komisionit dhe përfundimisht kërkoi rikonfirmimin në detyrë.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Eloida Goxhi, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa "a", të nenit 59, pika 1 në bazë të nenit 59, pika 4 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit znj. Eloida Goxhi, me detyrë prokurore, Drejtuese e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.
2. Me shumicë votash, transferimin e çështjes nr. *** akti të vitit 2013, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

3. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim, me përjashtim të pikës 2, mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 20.12.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila Pine
Kryesues

Suela Zhegu
Relator

Brunilda Bekteshi
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka

MENDIMI NË PAKICË

*Lidhur me denoncimin e ardhur pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 19.01.2018, që i përket denoncueses B. H. M.*

Objekti i denoncimit: Denoncohet, prokurore Eloida Goxhi, për zvarritje të hetimit.

Në ankesën e paraqitur denoncuesja B. H. M parashtroi se: “*Jam një pensioniste që kam 11 vjet nëpër gjyqe për pronën. Arsyeja për të cilën ju shkruaj është se gjyqtari Sh.Ç. dhe prokurore Eloida Goxhi kanë dhënë vendim kundër, në favor të palës hajdute të pronës. Znj. Eloida Goxhi, Drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, ka mbajtur rreth 2 vjet dosjen në sirtar dhe vetëm kur i jam drejtuar Prokurorisë Përgjithshme, atëherë e ka dërguar dosjen për gjykim, duke gënjyer dhe pa hetuar.*”

Lidhur me këtë çështje, prokurorja Eloida Goxhi, subjekti i rivlerësimit, është caktuar për të kryer, drejtuar dhe kontrolluar hetimet paraprake në procedimin penal me nr. *** të vitit 2013, më datë **17.09.2013**. Kjo është data e vendimit të Drejtuesit të Prokurorisë, ku është vendosur zëvendësimi i prokurorit të mëparshëm me prokuroren Eloida Goxhi, për vazhdimin e hetimeve në procedimin penal me nr. *** të vitit 2013.

Data 17.09.2013, është data nga duhet të vlerësohet dhe të gjykohet veprimtaria e prokurores Eloida Goxhi.

Pas marrjes së akteve të procedimit penal me nr. *** të vitit 2013, prokurori i çështjes, më datë 10.12.2013, ka urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore që të kryejë veprimet hetimore të përcaktuara në urdhrin me shkrim (ky është detyrimi i prokurores, të cilin e ka realizuar), duke vendosur si afat brenda të cilës do të përfundohej kryerja e veprimeve hetimore, datën 10.01.2014.

Sipas përshkrimit të rastit, rezulton se oficeri i policisë gjyqësore ka vijuar me kryerjen e veprimeve hetimore, dhe po ashtu edhe prokurori rezulton të ketë kryer veprime hetimore deri në momentin kur është vendosur pushimi i çështjes (data e vendimit të pushimit 30.09.2014). Në kushtet sa më sipër, **nuk është konstatuar zvarritje nga ana e subjektit të rivlerësimit**, për shkaqet si më poshtë:

- Bazuar në nenin 323¹¹ të Kodit të Procedurës Penale, afati i hetimeve paraprake të një procedimi penal, lidhet me faktin e regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale dhe përlllogaritja do të fillojë **nga data e regjistrimit të emrit**. Nëse në një procedim penal nuk ka të regjistruar emër të ndonjë personi që i atribuohet vepra penale, për të llogaritur afatet nuk do të zbatohet neni 323 i Kodit të Procedurës Penale, por do të

¹¹ Neni 323 “Afati i hetimeve paraprake”, para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale të vitit 2017 (ligji nr. 35/2017, datë 30.03.2017)

“1. Brenda tre muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj. 2. Kur është i nevojshëm autorizimi i procedimit, ecja e afatit pezullohet nga çasti që bëhet kërkesa deri në ditën kur autorizimi i vjen prokurorit.”

zbatohen afatet e përgjithshme të parashkrimit të ndjekjes penale të parashikuar në nenin 66¹² të Kodit Penal.

Në rastin konkret, në procedimin penal me nr. *** të vitit 2013, çështja është e regjistruar pa autor, që do të thotë se nuk është regjistruar emri i ndonjë personi që i atribuohet vepra penale dhe për këtë shkak afati i hetimeve paraprake llogaritet duke pasur parasysh parashikimet e nenit 66 të Kodit Penal.

- Janë kryer veprime hetimore mbi bazën e urdhrat të prokurorit dhe nga vetë prokurori janë kryer veprime hetimore deri në momentin e pushimit të çështjes. Nisur nga këto të dhëna, në mungesë të të dhënave të tjera mbi kohën e marrjes në dorëzim fizikisht të dosjes së procedimit penal me nr. *** të vitit 2013 nga ana e prokurorit; veprimet e kryera; kohën e kryerjes së veprimeve nga oficeri i policisë gjyqësore dhe prokurori; si dhe kompleksitetin e çështjes; mund të vlerësojmë se nga ana e prokurorit është treguar kujdes në ndjekjen dhe në kontrollin e hetimeve paraprake.
- Për të vlerësuar dhe arritur në konkluzionin se një zvarritje e pajustificuar, edhe në rast të provueshmërisë së saj, përbën shkelje të veprimtarisë hetimore të një prokurori, do të duhej që e njëjta problematikë të ish konstatuar edhe në disa procedime penale të ndjekura nga ana e kësaj prokurore (pra të kishim raste të përsëritura).
- Sjellim në vëmendje se vendimi i Gjykatës Kushtetuese me nr. 34, datë 10.04.2017, ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë disa dispozita të ligjit me nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku përfshihen edhe ato nga neni 101 - 104¹³ që parashikojnë se cilat akte e sjellje përbëjnë shkelje disiplinore.

Relatore e çështjes

Suela Zhegu

¹² Neni 66 “Parashkrimi i ndjekjes penale”, para ndryshimeve të Kodit Penal të vitit 2017 (ligjin nr. 36/2017, datë 30.3.2017). “Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar: a) njëzet vjet për krimet që parashikojnë dënim jo më të ulët se dhjetë vjet burgim ose dënim tjetër më të rëndë; b) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim nga pesë gjer në dhjetë vjet burgim; c) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë; ç) tre vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim gjer në dy vjet burgim; d) dy vjet për kundërvajtjet penale që parashikojnë dënim me gjobë.”

¹³ Neni 101 titulli: Shkeljet disiplinore dhe çështje të veprimtarisë.

Neni 102 titulli: Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit.

Neni 103 titulli: Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit.

Neni 104 titulli: Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së veprës penale.